



Webster Street, Dandenong, tetor 2025

Barrierat hiqen në tetor, rruga e re hapet vitin e ardhshëm



Për t'u përgatitur për më shumë trena, të cilët do të jenë edhe më të shpeshtë pas hapjes së tunelit të metrosë më vonë këtë vit, do ta mbyllim rrugën Webster te kalimi në nivel dhe do të ndërtojmë një rrugë të re nën linjën hekurudhore. Nënkalimi i ri do të lidhë rrugën Princes Highway-Lonsdale me rrugët Cheltenham dhe Hammond.

Barrierat do të hiqen në Dandenong dhe në linjat Cranbourne dhe Pakenham, kur rruga Webster të mbyllet te kalimi në nivel **të premten më 10 tetor nga ora 21:00**.

Nënkalimi rrugor i ri do të hapet në vitin 2026, dy vjet para afatit të parashikuar.

Para se ta mbyllim rrugën, do të hapim një shteg të ri për ecje dhe çiklizëm përgjatë rrugës Webster **të premten më 10 tetor nga ora 07:00**. Shtegu i ri do të lidhet me shtegun Dandenong Creek dhe do të ofrojë lidhje më të sigurta për këmbësorët dhe çiklistët.

Me ndërtimin e nënkalimit rrugor të ri, do të vazhdojmë të vendosim pilonë në pranverë para se të fillojë gërmimi i nënkalimit më vonë këtë vit.

Për të mundësuar mbylljen e sigurt të rrugës Webster në nivelin e kalimit dhe të përfundojmë punimet në korridorin hekurudhor, trenat do të zëvendësohen me autobusë në disa seksione të linjave Cranbourne dhe Pakenham **të premten më 10 tetor nga ora 20:30 deri në shërbimin e fundit, të enjten më 23 tetor**.

Planifikoni udhëtimin tuaj dhe qëndroni të informuar duke vizituar ptv.vic.gov.au/cranpak

Ndërsa ndërtojmë nënkalimin rrugor të ri, do të ketë ndryshime në mënyrën se si udhëtoni. Shihni brenda për më shumë informacion.

Pse duhet të hiqet ky kalim në nivel?



Deri në **10.000** automjete udhëtojnë nëpër këtë kalim çdo ditë



Barrierat janë të mbyllura për **më shumë se një orë** gjatë pikut të trafikut në mëngjes (nga ora 07:00 deri në orën 09:00)



22 aksidente të afërta që nga viti 2012



Regjistrohuni për përditësime
levelcrossings.vic.gov.au

**VICTORIA'S
BIG BUILD**

Rruga Webster do të mbyllet përgjithmonë në tetor

Rruga Webster do të mbyllet te kalimi në nivel nga ora 21:00, të premten më 10 tetor, duke u bërë më e qetë për banorët lokalë.

Me rrugën Webster të mbyllur te kalimi në nivel, do të ketë ndryshime në mënyrën se si udhëtoni nëpër Dandenong gjatë kohës që ndërtojmë nënkalimin rrugor të ri.

Rruga e devijimit do të jetë nëpër Hammond Road, Dandenong Bypass, Frankston-Dandenong Road, Princes Highway-Lonsdale Street, Foster Street dhe Cheltenham Road.

Rruga alternative e devijimit do të jetë nëpër Hammond Road, Cheltenham Road, George Street, Walker Street dhe Princes Highway-Lonsdale Street.

Automjetet mbi 3,8 metra duhet të marrin rrugën për automjete të larta nëpër Hammond Road, Dandenong Bypass, Frankston-Dandenong Road dhe Princes Highway-Lonsdale Street. Në këtë mënyrë, do të shmanget ura me lartësi të ulët në rrugën Cheltenham.

Nënkalimi rrugor i ri do të ketë një lartësi prej 5,8 metrash dhe do të jetë i përshtatshëm për automjetet e larta.

Herë pas here, këto rrugë mund të ndryshohen përkohësisht për shkak të mbylljeve të rrugëve ose korsive gjatë ndërtimit të nënkalimit rrugor të ri. Ndoshta do të ulen gjithashtu kufizimet e shpejtësisë – kushtojuni vëmendje tabelave dhe respektoni shpejtësitë më të ulëta për të mbajtur rrugët tona të sigurta për të gjithë.

Duke udhëtuar nëpër Dandenong Bypass, do jeni në mundësi të ktheheni në mënyrë të sigurt majtas dhe djathtas në udhëkryqet e sinjalizuara.



Legjenda



Kalim në nivel i mbyllur



Udhëkryq i sinjalizuar

Rrugë e mbyllur



NUK SHKALLËZOHET

Njihuni me ekipin

Merrni pjesë në seancën tonë informuese për t'u takuar me ekipin e projektit, për të bërë pyetje dhe për të mësuar më shumë rreth ndryshimeve në mënyrën se si do të lëvizni nëpër Dandenong kur të mbyllet rruga Webster.

Online nëpërmjet Zoom-it

E mërkurë, 8 tetor, ora 18:00 - 19:00

Prenotimet janë të domosdoshme.

Për t'u regjistruar në seancë dhe për të mësuar më shumë rreth ndryshimeve në mënyrën se si udhëtoni, skanoni kodin QR ose vizitoni levelcrossings.vic.gov.au/webster-travel-changes



Punimet e ardhshme

Para se të fillojë ndërtimi i nënkalimit rrugor të ri në lindje të linjës hekurudhore, do të zhvendosim shërbimet kryesore, duke përfshirë kabllot ajrore dhe tokësore, kanalizimin, gazin Multinet, ujin, NBN, Telstra dhe një tubacion të madh APA që shërben juglindjen e Melburnit.

Për shkak të rëndësisë së tubacionit, zhvendosja e tij do të zgjasë disa muaj dhe mund të bëhet vetëm në muajt e ngrohtë kur kërkesa është më e ulët. Zhvendosja e një prej tubacioneve kryesore të gazit në Melburn po zhvillohet në këtë moment dhe do të përfundojë në fillim të vitit të ardhshëm.

Para se të përfundojmë zhvendosjen e shërbimeve në lindje të linjës hekurudhore, do të fillojmë të gërmojmë nënkalimin rrugor të ri në perëndim të linjës hekurudhore.

Gërmimet e nevojshme për nënkalimin rrugor do të fillojnë në lindje të linjës hekurudhore pasi të përfundojë zhvendosja e shërbimeve në fillim të vitit 2026.

Punimet 24/7 këtë tetor

Në tetor do të punojmë 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë, në korridorin hekurudhor për të përfunduar sinjalizimin, punimet në shinat dhe ndërtimin e urës hekurudhore të re mbi nënkalimin rrugor të ri.

Për të siguruar që ekipet të përfundojnë në mënyrë të sigurt punimet në korridorin hekurudhor, trenat do të zëvendësohen me autobusë në disa seksione të linjave Cranbourne dhe Pakenham **nga ora 20:30, të premten më 10 tetor deri në shërbimin e fundit, të enjten më 23 tetor.**



Qëndroni të informuar

Planifikoni udhëtimin tuaj dhe qëndroni të informuar për ndërprerjet duke skanuar kodin QR ose duke vizituar **ptv.vic.gov.au/cranpak**

Ndërtimi i shtegut të ri të ecjes dhe çiklizmit përgjatë rrugës Webster



Shtegu juaj i ri për ecje dhe çiklizëm

Shtegu i ri për ecje dhe çiklizëm përgjatë rrugës Webster në Rezervatin Woodcock do të hapet **nga ora 07:00, të premten, më 10 tetor.**

Shtegu i ri do të shtrihet përgjatë anës jugore të përroit Dandenong

Creek, nën linjën hekurudhore, duke u lidhur me shtegun Dandenong Creek dhe duke u siguruar banorëve qasje në dyqanet dhe shërbimet lokale në CBD.

Kemi përmirësuar dizajnin e shtegut të ri duke përfshirë një shëtitore të

shtruar me dërrasa që po ndërtohet rreth një peme të madhe River Red Gum në Rezervatin Woodcock.

Gjatë punimeve, do të ketë mbyllje të përkohshme të korsive dhe devijime për këmbësorët.

Përmbledhja e punimeve në gusht

Faleminderit për durimin tuaj gjatë fushatës ndërtimore dyjavore në korridorin hekurudhor kur qarkullimi i trenave është ndërprerë. Gjatë kësaj kohe:



kemi vendosur 54 pilonë për të mbështetur nënkalimin rrugor të ri dhe urën hekurudhore mbi nënkalimin



kemi bërë gërmime për shërbimet nëntokësore



kemi punuar në instalimin e linjave elektrike ajrore



kemi vazhduar ndërtimin e shtegut të ri të ecjes dhe çiklizmit përgjatë rrugës Webster.

Përparimi i projektit në fotografi



Punimet në linjat elektrike ajrore në korridorin hekurudhor



Dy pajisje për vendosjen e pilonëve gjatë fushatës ndërtimore në gusht



Punimet e sinjalizimit në korridorin hekurudhor



Vendosja e pilonëve në korridorin hekurudhor



Rivendosja e balastit dhe shinave



Punimet janë në vazhdim, dyqanet janë të hapura

Dyqanet në rrugët Lonsdale – Service Road dhe Thomas Street janë të hapura për biznes.

Faleminderit që mbështetni bizneset lokale në Dandenong ndërsa ndërtimi vazhdon.

Ju mund të vizitoni, të blini dhe të hani në rrugët Lonsdale – Service Road dhe Thomas Street gjatë punimeve të ndërtimit.

Blini në dyqanet lokale dhe mbështetni tregtarët tuaj lokalë në zonën Lonsdale – Service Road dhe Thomas Street:



Dyqane

- Manilal & Sons
- Pajisjet shtëpiake Opal



Kafene dhe restorante

- Acai Crush
- Kafe-bari dhe restoranti Beletti
- Restoranti Darbar
- Kafeneja dhe ëmbëltorja Fixhi



Shërbime

- Frizeri Aye
- Capri Blinds
- Dandenong Central Apartments
- Dandy Parking
- Good Therapy Dandenong
- Administratorët shtetërorë
- Salloni i bukurisë Sri Lanka



Do të hiqen barrierat në linjat Cranbourne dhe Pakenham

Kur ta mbyllim rrugën Webster te kalimi në nivel muajin e ardhshëm, do të heqim barrierat në linjat Cranbourne dhe Pakenham. Në këtë mënyrë, komuniteti ynë do të përgatitet për më shumë trena, më të shpeshta, kur të hapet tuneli i metrosë më vonë këtë vit.

Tuneli i metrosë do të lidhë linjat Cranbourne dhe Pakenham me linjën Sunbury, duke krijuar një linjë hekurudhore direkte të re nga Sunbury në perëndim deri në East Pakenham në juglindje, me një flotë trenash të dedikuar dhe moderne dhe pesë stacione të reja.

Kur barrierat e rrugës Webster të hiqen në tetor dhe tuneli i metrosë të hapet më vonë këtë vit, 30 barrierat do të hiqen në linjat Sunbury dhe Pakenham dhe trenat do të udhëtojnë 100 kilometra nga East Pakenham në Sunbury pa asnjë kalim në nivel.



Pamja nga perëndimi drejt nënkalimit rrugor të ri. Përshtypja e artistit, mund të ndryshojë

Afati kohor i projektit



2019

- Projekti u njoftua



2022 deri në fund të vitit 2023

- Hetimet në terren, sondazhet e trafikut dhe punimet e planifikimit



Nëntor 2023

- Dizajnet konceptuale janë lëshuar
- Konsultimi me komunitetin
- Hetimet në terren vazhdojnë



Fundi i vitit 2024

- Dizajnet përfundimtare janë lëshuar
- Punimet e para



2025

- Fillon ndërtimi
- Hapet shtegu i ecjes dhe çiklizmit nën hekurudhën
- Rruga Webster mbyllet te kalimi në nivel
- Barrierat hiqen përgjithmonë



2026

- Ndërtimi
- Nënkalimi rrugor i ri hapet dy vjet më herët
- Sistemimi i hapësirave të jashtme

* Afatet kohore mund të ndryshojnë.



Regjistrohuni për përditësime me SMS lidhur me projektin e heqjes së kalimit në nivel në rrugën Webster

Skano kodin QR ose dërgoni tekstin **WEBSTER** në **0428 581 917**

Qëndroni të informuar



Përditësimet me postë elektronike

levelcrossings.vic.gov.au/subscribe



Lajmet e fundit të projektit

facebook.com/levelcrossings



Për më shumë informacion

levelcrossings.vic.gov.au

levelcrossings.vic.gov.au

contact@levelcrossings.vic.gov.au



Për gjuhë të tjera përveç anglishtes, ju lutemi të telefononi në 9209 0147.

1800 105 105 (telefononi në çdo kohë)

[Instagram](#) [Facebook](#) [YouTube](#) [X](#) [LinkedIn](#)

Ju lutemi të na kontaktoni nëse dëshironi këtë informacion në një format të arritshëm. Nëse keni nevojë për ndihmë për shkak të një dëmtimi të dëgjimit ose të të folurit, vizitoni relayservice.gov.au

